

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 858, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka për qëllim rregullimin e përcaktimit të kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, që janë miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në qershor 2025 u miratua nga parlamenti shqiptar ligji nr. 43/2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt””, shpallur me dekretin nr. 221, datë 08.07.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Ligji ndër të tjera parashikon edhe rishikimin e akteve në fuqi me qëllim rregullimin e regjimit të hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë (RSH), në përputhje me ndryshimet ligjore të miratuara.

Rishikimi i vendimit të sipërcituar kryhet me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e kuadrit rregullator ekzistues. Ndryshimet synojnë rregullimin dhe qartësimin e procedurave të aplikimit online për vizë dhe leje qëndrimi/unike, duke lehtësuar procesin për aplikuesit dhe qartësuar më tej institucionet përkatëse të përfshira në procedurë. Një element i rëndësishëm i rishikimit është edhe përcaktimi i kriterëve të posaçme për përfitimin e lejes unike si punëtor shtëpie.

Projektvendimi synon rregullimin e procedurave dhe rishikimin e dokumentacionit për pajisjen me leje qëndrimi/unike dhe vizë, sipas motiveve të caktuara, referuar nevojave të identifikuara dhe nga strukturat përkatëse të ngarkuara me zbatimin e vendimit.

Gjithashtu, bëhet saktësimi i dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me Kartëqëndrim të familjarëve të shtetasve të Bashkimit Evropian, si dhe për përcaktimin e procedurës së lëshimit të Certifikatës së Regjistrimit për shtetasit e Bashkimit Evropian dhe dokumentacionin përkatës që nevojitet.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi ka karakter teknik dhe është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet e propozuara në këtë projektakt janë të domosdoshme, pasi nëpërmjet tyre përmirësohet përcaktimi i kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e shtetasve të huajve në Republikën e Shqipërisë, si dhe përmirësimin dhe saktësimin e formularëve të aplikimit për të gjitha lejet e qëndrimit dhe lejet unike.

Ndryshimet synojnë rregullimin dhe qartësimin e procedurave të aplikimit online për vizë, leje qëndrimi/ unike dhe certifikatë regjistrimi dhe kartëqëndrimi, duke lehtësuar procesin për aplikuesit dhe institucionet përkatëse.

Projektakti i paraqitur ka për objekt rregullimin e plotë dhe të detajuar të një sërë çështjesh procedurale dhe administrative që lidhen me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke synuar përmirësimin e kuadrit ekzistues nënligjor, si dhe adresimin e problematikave të konstatuara gjatë zbatimit praktik të tij.

Në këtë kuadër, projektakti trajton në mënyrë të veçantë secilën nga çështjet e mëposhtme:

Së pari, projektakti rregullon procedurat e aplikimit online për vizë, leje qëndrimi dhe leje unike, duke synuar unifikimin e praktikave administrative dhe standardizimin e hapave proceduralë që ndiqen nga aplikuesit dhe autoritetet kompetente. Këto ndryshime synojnë të rrisin transparencën, të shmangin paqartësitë dhe të ulin barrën administrative për subjektet që aplikojnë. Për të aplikuar për vizë, shtetasi i huaj aplikon on-line duke qenë jashtë territorit të RSH-së në sistemin elektronik të vizave ose paraqitet personalisht në Misionin Diplomatik apo Postin Konsullor.

Është shtuar një parashikim i ri ligjor, sipas të cilit përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me vizë për hyrje dhe qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një periudhë deri në 90 ditë brenda 180 ditëve, për qëllime të barasvlershme me ato të vizës së tipit “C”, të parashikuara në ligjin Për të huajt, shtetasit e vendeve të treta që janë të pajisur me vizë të vlefshme me shumë hyrje-dalje ose me leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuara nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Ky parashikim synon lehtësimin e lëvizjes së ligjshme dhe harmonizimin e praktikave me standardet evropiane.

Në kuadër të dokumentacionit bazë të nevojshëm për të gjitha kategoritë e aplikuesve për pajisje me vizë, është shtuar si kërkesë paraqitja e lejes së qëndrimit mbi 12 muaj, të lëshuar nga shteti ku aplikuesi ka rezidencën e ligjshme, me vlefshmëri jo më pak se 3 muaj përtej afatit të vizës së kërkuar. Alternativisht, aplikuesi mund të paraqesë viza të mëparshme ose aktuale të vlefshme, si vizë Shengen, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Mbretërisë së Bashkuar, si dhe viza shqiptare, qoftë në formë elektronike apo me pullë. Ky saktësim synon forcimin e verifikimit të statusit të qëndrimit dhe historikut të udhëtimit të aplikuesve.

Janë realizuar përmirësime dhe saktësime të rëndësishme në kuadër të kategorive të vizës së tipit “D” dhe lejes unike për shtetasit që i nënshtrohen regjimit të vizave, me synim rritjen e qartësisë, plotësisë dhe efektivitetit të procedurave të aplikimit. Në këtë drejtim, është rishikuar dhe përditësuar dokumentacioni i përgjithshëm i kërkuar për këto kategori, duke garantuar një trajtim më të unifikuar dhe të standardizuar të aplikimeve.

Gjithashtu, janë bërë përmirësime në dokumentacionin shtesë për vizë për motive të bashkimit familjar, vizë e tipit “D/BF”, duke saktësuar dokumentet provuese që lidhen me marrëdhënien familjare, qëndrimin e ligjshëm dhe kushtet e pritjes në Republikën e Shqipërisë.

Një risi e rëndësishme e projektaktit është shtimi i një kategorie të veçantë të dokumentacionit shtesë për vizë të tipit “D” për punëtor shtëpie (D/PSH), e cila përcakton qartë kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme për këtë kategori aplikuesish, në funksion të formalizimit të marrëdhënieve të punës dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre. Po ashtu, është shtuar dokumentacion shtesë për vizë të tipit “D” për sportistë (D/SP), konkretisht dokumenti që vërteton regjistrimin e shtetasit të huaj në federatën sportive përkatëse në vendin e origjinës. Ky parashikim qartëson më tej kategorinë e sportistëve që hyjnë në vend për këtë qëllim dhe ndihmon në parandalimin e keqpërdorimeve të kësaj kategorie vizash.

Është qartësuar dokumentacioni shtesë për vizë për motive studimi (student dhe nxënës) D/ST, duke parashikuar që dëshmia financiare të jetë në gjuhën shqip dhe/ose angleze, që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit në vlerën 300 000 lekë, ose në vlerën ekuivalente në euro të kursit të këmbimit valutor në Republikën e Shqipërisë në datën e aplikimit, në një bankë në vendin e origjinës.

Projektakti parashikon përmirësimin dhe ristrukturimin e seksionit B, i cili rregullon dokumentacionin e përgjithshëm dhe të nevojshëm për pajisjen me të gjitha llojet e lejeve të qëndrimit, me synim rritjen e qartësisë normative, unifikimin e praktikave administrative dhe garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të legjislacionit në fuqi për të huajt.

Ndryshimet e propozuara adresojnë problematikat e evidentuara gjatë zbatimit praktik të procedurave dhe synojnë forcimin e sigurisë juridike, si për aplikuesit, ashtu edhe për autoritetet kompetente. Në këtë kuadër, është shtuar si kërkesë e përgjithshme paraqitja e certifikatës së gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti), e cila duhet të jetë e lëshuar jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit. Kjo kërkesë aplikohet për të gjitha kategoritë e lejeve të qëndrimit, me përjashtim të aplikantëve nën moshën 16 vjeç dhe mbi moshën 75 vjeç, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe duke marrë në konsideratë kategoritë vulnerabël. Ky parashikim synon rritjen e nivelit të verifikimit të integritetit dhe sigurisë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, është përmirësuar dokumentacioni shtesë për rastet humanitare të tipit “A”, duke saktësuar në mënyrë të posaçme dokumentin provues për të miturit e huaj të braktisur. Ky dokument duhet të vërtetojë se i mituri është i kategorizuar si i mitur i braktisur ose se ka mbetur pa mbrojtje prindërore, kujdestari apo shoqërues për arsye të tjera. Krahas këtij dokumenti, parashikohet edhe paraqitja e një kërkesë formale për pajisje me leje qëndrimi, e paraqitur nga vetë i mituri ose nga kujdestari i tij ligjor, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës dhe respektimin e të drejtave themelore të tij.

Në lidhje me dokumentacionin shtesë për lejen unike si punëtor stinor, është shtuar kërkesa për paraqitjen e një dokumenti që vërteton se i huaji plotëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin përkatës, në rastet kur aktiviteti që do të ushtrojë përfshihet në kategorinë e profesioneve të rregulluara. Ky dokumentacion mund të përfshijë diploma, certifikata profesionale ose referenca, dhe synon garantimin e ushtrimit të ligjshëm dhe cilësor të profesionit.

Një risi e rëndësishme e projektaktit është përcaktimi i dokumentacionit shtesë për lejen unike si punëtor shtëpie, kategori e re e integruar në muajin qershor në ligjin “Për të huajt”. Ky përcaktim synon formalizimin e kësaj kategorie punësimi dhe mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve. Paralelisht, është përmirësuar dokumentacioni i kërkuar për ripërtëritjen e lejes së përkohshme të qëndrimit të tipit “B”, duke qartësuar kriteret dhe procedurat, në funksion të një procesi administrativ më efikas dhe transparent.

Projektakti saktëson dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me leje qëndrimi për investitorë, duke synuar eliminimin e paqartësive ekzistuese dhe sigurimin e një procesi të qartë dhe të parashikueshëm për këtë kategori aplikuesish, në funksion të nxitjes së investimeve të huaja.

Është rregulluar procedura e pagesës dhe vlefshmërisë së tarifës së lejes së qëndrimit, që tashmë është e vlefshme për një periudhë 30 ditore për riaplikim në rast refuzimi. Si dhe parashikohet se pas pranimit të kërkesës, autoriteti i kufirit dhe migracionit pajis brenda 1 (një) ditë pune të huajin me leje provizore, me afat vlefshmërie 1 (një) muaj, e cila zgjatet për atë kohë sa është e nevojshme për marrjen e vendimit për miratimin apo refuzimin e kërkesës për pajisjen me leje qëndrimi apo leje unike. Këto parashikime nuk ishin më parë.

Së dyti, parashikohet saktësimi i dokumentacionit dhe i procedurës për pajisjen me Kartëqëndrim të familjarëve të shtetasve të Bashkimit Evropian, si dhe për lëshimin e Certifikatës së Regjistrimit për shtetasit e BE-së. Ky saktësim synon harmonizimin me standardet evropiane dhe garantimin e ushtrimit efektiv të së drejtës së lëvizjes dhe qëndrimit të lirë. Certifikata e Regjistrimit dhe Kartëqëndrimi, janë pa tarifë shërbimi.

Së treti, projektakti përfshin gjithashtu përmirësime në formularët elektronikë që përdoren në platformën e-Albania, me qëllim rritjen e funksionalitetit dhe përdorshmërisë së tyre. Në këtë kuadër, kryhet një vlerësim i dokumentacionit të kërkuar, për të evidentuar dhe shmangur rastet e dublikimit midis aplikimeve për vizë dhe për leje qëndrimi.

Në përfundim, projektakti parashikon përmirësimin e formularit për lejen unike në platformën e-Albania, duke shtuar parashikime të posaçme për kategorinë “punëtor shtëpie”, si dhe integrimin e formularëve të rinj për aplikimin e shtetasve të BE-së dhe familjarëve të tyre që do të pajisen me certifikatë regjistrimi apo kartëqëndrim për anëtarët e familjes së shtetasve të BE-së që nuk janë shtetas të BE, me synim lehtësimin, qartësimin dhe standardizimin e të gjithë procesit administrativ.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Projektvendimi propozohet në bazë të nenit 100, të Kushtetutës me propozimin e Ministrit të Punëve të Brendshme.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është i përbërë nga 7 pika, të cilat në mënyrë të përmbledhur parashikojnë si më poshtë:

Në pikën 1 kudo në tekst fjalët “Ministri i Brendshëm” dhe “Ministria e Brendshme” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “Ministri i Punëve të Brendshme” dhe Ministria e Punëve të Brendshme”.

Pika 2, në Kreun II “Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, janë integruar parashikime lidhur me kriteret e vizave, janë përcaktuar autoritetet pëe trajtimin e vizave, është përditësuar dokumentacioni, si dhe kriteret për aplikuesit për vizë.

Pika 3, parashikon se në Kreun III, “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me leje qëndrimi”, integrohen përmirësime lidhur me lejen provizore, e cila zgjatet për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e vendimit për miratimin apo refuzimin e kërkesës për pajisjen me leje qëndrimi apo leje unike. Përmirësime lidhur me kriteret dhe dokumentacionin e përgjithshëm për leje qëndrimi dhe unike. Është shtuar si dokument certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti) të marrë jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit, për të gjitha llojet e lejeve të qëndrimit përjashtuar për aplikantë nën moshën 16 vjeç dhe mbi moshën 75 vjeç. Parashikohen përmirësime lidhur me pajisjen me leje qëndrimi për të miturit e braktisur ose që kanë mbetur pa mbrojtje prindërore, kujdestari apo shoqërues. Përcaktohet dokumentacioni shtesë për leje qëndrimi për investitorë.

Është rregulluar procedura e pagesës dhe vlefshmërisë së tarifës së lejes së qëndrimit, që tashmë është e vlefshme për një periudhë 30 ditore për riaplikim në rast refuzimi. Si dhe parashikohet se pas pranimit të kërkesës, autoriteti i kufirit dhe migracionit pajis brenda 5 ditëve të huajin me leje provizore, me afat vlefshmërie 2 (dy) muaj. Si dhe parashikime për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, dokumentacioni nga vendi i origjinës së të huajit.

Në pikën 4, parashikohet procedura, kriteret dhe dokumentacioni për lëshimin e “certifikatës së regjistrimit” për shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian. Përcakton procedurën e aplikimit, dokumentacionin dhe kriteret për pajisjen me “Certifikatë regjistrimi” të shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian, të cilët qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për periudha më të gjata se tre (3) muaj, në përputhje me nenin 33/1 të ligjit nr.79/2021 “Për të huajt”, të ndryshuar. Parashikohet procedura, kriteret dhe dokumentacioni për lëshimin e “kartëqëndrimit të një anëtarit të familjes së një shtetasi të BE-së”.

Në pikën 5, parashikohen dispozita të fundit dhe kalimtare që sqarojnë se “Procedura e aplikimit për lejen e qëndrimit për investitor, lejen Unike për punëtor shtëpie, për Certifikatë Regjistrimi dhe Kartëqëndrimi, do të jetë funksionale pas reflektimit në e-albania të ndryshimeve të parashikuara në Kreun IV, Seksioni B, gërma “a” dhe Kreu V, Seksioni B, gërma “b”. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, reflektimin në platformën e-albania të parashikimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij Kreu, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”.

Pika 6, paraqet ndryshimet dhe shtesat në Anekse, ku rregullohet se Certifikata e Regjistrimit dhe Kartëqëndrimi, janë pa tarifë shërbimi. Kategoria “Punëtor shtëpie integrohet në formularin e lejes unike. Në këtë formular riformulohet edhe informacioni mbi punesimin. Kategoria investitor integrohet në formularin nr.9, në kategorinë për motive të tjera.

Në pikën 7, përcaktohet se ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohen, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe AKSHI.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga një grup ndërinstitutional pune, ngritur me urdhër Kryeministri nr.210 datë 10.11.2025, me qëllim hartimin e projektakteve nënligjore që burojnë nga ligji nr. 43/2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt””.

Mbledhjet e Grupit ndërinstitutional të punës u drejtuan nga Ministria e Punëve të Brendshme, nën drejtimin institucional të Zëvendësministres së Brendshme, znj. Silva Caka, e cila siguroi koordinimin ndërinstitutional dhe orientimin strategjik të punës së grupit. Grupi i punës përbëhej nga gjithsej 14 anëtarë, përfaqësues të

institucioneve kryesore përgjegjëse në fushën e migracionit, vizave, punësimit, sigurisë dhe shërbimeve elektronike.

Në përbërje të tij morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme, konkretisht nga Drejtoria e Çështjeve Konsullore, si dhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, përmes strukturave përgjegjëse për politikën e punësimit dhe migratore. Ministria e Arsimit nuk ndoqi mbledhjet e GNP-së, si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk solli përfaqësues në këtë proces.

Në total janë zhvilluar 7 mbledhje të Grupit ndërinstitucional të punës, të cilat janë mbështetur nga sekretariati teknik për migracionin (sektori i migracionit), në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOR

Ky projektvendim nuk ka efekte financiare shtesë, për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Albana KOÇIU